



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së  
/për tremujorin e tretë 2016/  
**-Raport i ndërmjetëm i pa audituar-**

**Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar**

## Pasqyrat financiar te BQK-së për tremujorin e tretë 2016

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209“Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (me iniciale BQK),si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të ligjit të përmendur me lartë. Këto pasqyra për tremujorin e tretë përfshijnë *pasqyrën e gjendjes financiare dhe llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet).*

Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të tretë është 30 shtator 2016.

### **Shkurtesa te përdorura ne Raport:**

BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

DST (SDR) – Te Drejtat Speciale te Tërheqjes

TI – Teknologjia Informative

SNP – Sistemi ndërbankar i pagesave


## Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me


	Shënim	30 Shtator 2016	31 Dhjetor 2015
<b>Mjetet</b>			
Paraja e gatshme	5	183,524,699.56	15,281,539.78
Llogarit rrjedhëse me bankat e huaja	6	214,238,196.88	241,187,046.29
Letrat me vlerë	7	538,580,356.09	127,318,651.52
Plasmanët në tregun e parasë	8	375,228,381.34	805,309,147.18
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	282,763,846.18	268,277,311.19
Prona dhe pajisjet	10	3,280,641.20	2,372,019.28
Mjetet e paprekshme	11	2,057,592.90	1,552,339.99
Mjete tjera	12	1,159,425.58	896,746.06
<b>Gjithsej mjetet</b>		<b>1,600,833,139.73</b>	<b>1,462,194,801.29</b>
<b>Detyrimet</b>			
Ndaj bankave komerciale në vend	13	278,451,799.78	316,405,868.73
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	14	289,724,317.74	273,894,284.53
Ndaj institucioneve qeveritare	15	886,125,160.41	735,743,858.63
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	90,960,843.70	82,648,973.70
Nga huamarrja/et	17	1,310,961.46	680,116.58
Detyrime tjera vendore	18	1,664,035.70	1,799,115.31
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,548,237,118.79</b>	<b>1,411,172,217.48</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i autorizuar	19	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondi rezervë	20	21,022,583.81	20,334,791.90
Neto rezultati i periudhës		1,573,437.13	687,791.91
<b>Gjithsej kapitali dhe rezervat</b>		<b>52,596,020.94</b>	<b>51,022,583.81</b>
<b>Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat</b>		<b>1,600,833,139.73</b>	<b>1,462,194,801.29</b>

Shënimet prej faqes 6 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të shpалosura më poshtë janë aprovuar nga menaxhmenti me datë 24 Nëntor 2016 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Bedri Hamza  
Guvernator



Faton Ahmetaj  
Drejtor për planifikim dhe  
raportim financiar

## Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

	Shënim	30 Shtator 2016	30 Shtator 2015
<b>Te hyrat nga interesi (kamata)</b>			
Të hyrat nga interesi		1,373,014.15	353,948.09
Shpenzimet nga interesi		(52,203.08)	(38,087.42)
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	21	<b>1,320,811.07</b>	<b>315,860.67</b>
<b>Te hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>			
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		1,407,197.09	1,041,880.41
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(199,077.17)	(290,364.03)
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>	22	<b>1,208,119.92</b>	<b>751,516.38</b>
<b>Te hyrat nga aktiviteti rregullator dhe t 'hyra tjera operative</b>			
Të hyrat nga aktiviteti rregullator	23	2,948,594.70	2,493,846.13
Të hyrat nga grantet	24	49,964.52	49,964.52
Të hyrat tjera operative	25	4,127.99	1,176.17
<b>Të ardhurat operative</b>		<b>5,531,618.20</b>	<b>3,612,363.87</b>
<b>Shpenzimet administrative (operative)</b>			
Shpenzimet për personelin	26	(2,768,737.21)	(2,501,246.96)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(488,346.51)	(408,609.15)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	27	(804,133.80)	(735,316.20)
<b>Shpenzimet administrative (operative)</b>		<b>(4,061,217.52)</b>	<b>(3,645,172.31)</b>
<b>Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit</b>		<b>1,470,400.68</b>	<b>(32,808.44)</b>
Neto fitimi/humbja nga kursi i këmbimit valutor	28	103,036.45	(122,917.09)
<b>Neto rezultati i periudhës</b>		<b>1,573,437.13</b>	<b>(155,725.53)</b>

Shënimet prej faqes 6 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

	<b>Kapitali i Autorizuar</b>	<b>Fond i rezervave</b>	<b>Neto rezultati i periudhës</b>	<b>Gjithsej</b>
<i>Saldo me 01 Janar 2015</i>	<b>30,000,000.00</b>	<b>19,949,414.03</b>	<b>385,377.87</b>	<b>50,334,791.90</b>
<i>Rezultati financiar i periudhës</i>	-	-	687,791.91	687,791.91
<i>Transferi në fondin rezervë</i>	-	385,377.87	(385,377.87)	-
<i>Transferi në kapital të autorizuar</i>	-	-	-	-
<b><i>Saldo me 31 Dhjetor 2015</i></b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>20,334,791.90</b>	<b>687,791.91</b>	<b>51,022,583.81</b>
<b><i>Saldo me 01 Janar 2016</i></b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>20,334,791.90</b>	<b>687,791.91</b>	<b>51,022,583.81</b>
<i>Rezultati financiar i periudhës</i>	-	-	1,573,437.13	1,573,437.13
<i>Transferi në fondin rezervë</i>	-	687,791.91	(687,791.91)	-
<i>Transferi në kapital të autorizuar</i>	-	-	-	-
<b><i>Saldo me 30 Shtator 2016</i></b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>21,022,583.81</b>	<b>1,573,437.13</b>	<b>52,596,020.94</b>

Shënimet prej faqes 6 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

## Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

### 1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209“Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” të aprovuar në Korrik të vitit 2010.

### 2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### **Korniza Raportuese**

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### **Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### **Valuta e funksionale dhe e prezantuar**

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, qe është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të këtë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

### 3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël, dhe duhet theksuar se nuk ka pasur ndonjë politikë të re ose ndryshim në politikat e aplikuara kontabël.

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e : rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Rreziku financiar në BQK ndërlihet më së shumti me punët e menaxhimit të mjeteve dhe kryesisht menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve në përputhje me politikën e menaxhimit të mjeteve të aprovuar nga Bordi i BQK-së. Mjetet e ekspozuara nga aktiviteti i menaxhimit financiar të tyre janë kryesisht në shtete të Bashkimit Evropian me vlerësim kreditor shumë të mirë (prej A-1 deri A-3/ P-1 deri P-2).

## Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)

## Vlerat bartëse sipas maturitetit të mbetur

	Shënim	Shuma e bartur	< 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-6 vjet
<b>30 Shtator 2016</b>						
<b>Mjetet</b>						
Paratë e gatshme	5	183,524,699.56	183,524,699.56	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat Jo-rezidente	6	214,238,196.88	214,238,196.88	-	-	-
Letra me vlerë	7	538,580,356.09	30,409,939.94	134,638,595.06	321,631,482.98	51,900,338.11
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	8	375,228,381.34	230,199,702.19	40,024,333.33	105,004,345.83	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	282,763,846.18	158,785,444.34	-	-	123,978,401.84
		<b>1,594,335,480.05</b>	<b>817,157,982.91</b>	<b>174,662,928.39</b>	<b>426,635,828.81</b>	<b>175,878,739.95</b>
<b>Detyrimet</b>						
Ndaj bankave vendore	13	(278,451,799.78)	(278,451,799.78)	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(289,724,317.74)	(165,745,915.90)	-	-	(123,978,401.84)
Ndaj institucioneve qeveritare vendore	15	(886,125,160.41)	(886,125,160.41)	-	-	-
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	16	(90,960,843.70)	(90,960,843.70)	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(1,310,961.46)	(1,310,961.46)	-	-	-
Detyrime tjera vendore	18	(1,664,035.70)	(1,664,035.70)	-	-	-
		<b>(1,548,237,118.79)</b>	<b>(1,424,258,716.95)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(123,978,401.84)</b>
		<b>46,098,361.26</b>	<b>(607,100,734.04)</b>	<b>174,662,928.39</b>	<b>426,635,828.81</b>	<b>51,900,338.11</b>
<b>31 Dhjetor 2015</b>						
<b>Mjetet</b>						
Paratë e gatshme	5	15,281,539.78	15,281,539.78	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat Jo-rezidente	6	241,187,046.29	241,187,046.29	-	-	-
Letra me vlerë	7	127,318,651.52	56,399,152.68	5,135,136.68	6,114,202.43	59,670,160.22
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	8	805,309,147.18	185,060,440.28	95,026,607.53	525,222,099.36	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	268,277,311.19	149,589,561.19	9,777,000.00	29,331,000.00	79,579,750.00
		<b>1,457,373,695.96</b>	<b>647,517,740.22</b>	<b>109,938,744.21</b>	<b>560,667,301.79</b>	<b>139,249,910.22</b>
<b>Detyrimet</b>						
Ndaj bankave vendore	13	(316,405,868.73)	(316,405,868.73)	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	14	(268,277,311.19)	(149,589,561.19)	(9,777,000.00)	(29,331,000.00)	(79,579,750.00)
Ndaj institucioneve qeveritare vendore	15	(735,743,858.63)	(735,743,858.63)	-	-	-
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	16	(82,648,973.70)	(82,648,973.70)	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(680,116.58)	(680,116.58)	-	-	-
Detyrime tjera vendore	18	(1,799,115.31)	(1,799,115.31)	-	-	-
		<b>(1,405,555,244.14)</b>	<b>(1,286,867,494.14)</b>	<b>(9,777,000.00)</b>	<b>(29,331,000.00)</b>	<b>(79,579,750.00)</b>
		<b>51,818,452</b>	<b>(639,349,754)</b>	<b>100,161,744</b>	<b>531,336,302</b>	<b>59,670,160</b>

**5. Paraja e gatshme**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Paraja e gatshme	183,524,699.56	15,281,539.78
<b>Gjithsej</b>	<b>183,524,699.56</b>	<b>15,281,539.78</b>

Vërehet rritje e konsiderueshme e saldosh me 30 Shtator 2016. Kjo rrjedh nga pamundësia e plasimit (afatizimit) të mjeteve në tregjet financiare si rrjedhojë e normave shumë të ulëta dhe negative. Kështu është vendosur që mbahen me shumë mjete si para të gatshme për të ju ikur normave negative që bankat korrespondente na ngarkojnë mbi limite të caktuara.

**6. Llogaritë rrjedhëse me bankat jo vendore**

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jo vendore është si më poshtë:

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Deutsche Bundesbank	8.73	68.10
Raiffeisen Zentralbank	29,660,344.60	152,006,000.43
Deutsche Bank London AG	54,132,933.19	79,161,507.42
Nostro Acc.Pohjola Bank Plc	-	9,996,970.34
Nostro Acc. Commerzbank AG	129,444,917.86	22,500.00
Nostro Acc. Bayerische Landesbank	999,992.50	-
<b>Gjithsej</b>	<b>214,238,196.88</b>	<b>241,187,046.29</b>

Kemi zvogëlim të pozicionit të *llogarive rrjedhëse* krahasuar me 31 dhjetor 2015. Mirëpo nëse i shikojmë pozicionin e zërit *Letrat me vlerë (shiko shënim 7)* vërejmë lehtë se kemi rritje në kuadër të *shënit 7*. Këto ndryshime janë të rrjedha nga aktiviteti normal i menaxhimit të portfolios së mjeteve (përkatësisht shënimeve 6, 7 dhe 8 që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve).

**7. Letrat me Vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)**

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupimit me shënim 7 janë letra të borxhit qeveritare të lëshuara nga vendet sipas listimit me poshtë (në tabelën *sipas shteteve*). Bonot e thesarit të shpalosura më poshtë kanë maturitet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveritare kanë maturitet deri në tri vite. Të gjitha janë në Euro dhe kanë norma të interesit efektiv që lëvizin nga 0.008% deri 2.696% vjetore në vitin 2016 (në vitin 2015: 0.016% deri në 2.696% vjetore).

Bonot e thesarit janë emetime nga qeveritë e vendeve si më poshtë:

**Sipas shteteve:**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Holandë	50,246,072.32	50,490,215.35
Itali	370,227,054.89	49,996,275.02
Kosovë	118,107,229.88	26,832,161.63
<b>Gjithsej</b>	<b>538,580,356.09</b>	<b>127,318,652.01</b>



**Letra me vlerë (vazhdim)****Sipas llojit:**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Bono Thesari	37,122,280.67	64,513,565.02
Obligacione qeveritare	501,458,075.42	62,804,971.99
<b>Gjithsej</b>	<b>538,580,356.09</b>	<b>127,318,537.01</b>

Të ky grupim vërehet një rritje e pozicionit krahas periudhës 31 Dhjetor 2015 që është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios, kryesisht i bazuar në normë optimale të kthimit.

**8. Plasmanët me bankat jo-vendore**

Ne kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat jo vendore. Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e tretë 2016 mesatarisht është rreth 0.122% ( minimum. 0.020% dhe maksimum. 0.440%), ndërsa në vitin 2015: min. 0.010% në 0.260% me mesatare prej 0.0661%). Këto plasmane kryesisht kanë maturitetet të kontraktuar deri në një vit. Analitika sipas bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë:

<b>Plasmanët sipas bankave:</b>	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Raiffeisen Zentralbank	255,176,845.23	200,131,408.34
ING Bank	60,019,077.78	185,031,462.50
Rabobank	-	90,043,688.49
Danske Bank	60,032,458.33	140,027,696.18
Deutsche Bank	-	160,072,725.00
Pohjola	-	30,002,166.67
<b>Gjithsej</b>	<b>375,228,381.34</b>	<b>805,309,147.18</b>

**Plasmanët sipas valutave:**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
	<b>vlera në EUR</b>	<b>vlera në EUR</b>
në EUR	355,177,173.60	805,309,147.18
në USD	20,051,207.74	-
	<b>375,228,381.34</b>	<b>805,309,147.18</b>

Që prej 01 Mars 2016 në portfolion e investimeve kemi edhe plasmane në valutën e Dollarit Amerikan (USD).

Ashtu sikurse edhe vërehet lehtë nëse krahasojmë 31 dhjetor 2015 dhe 30 shtator 2016 mund të shihet se ka zvogëlim të pozicionit (përkatesisht zërit) në fjale në kuadër të grupimi nën shënim 8. Kjo ka rrjedhë nga se në tregjet financiare (veçanërisht për valutën euro) normat e interesit janë kryesisht negative. Mundësitë për të investuar me normë pozitive të kthimit në një plasman në tregun e parasë për valutën euro janë të shumë të limituara.

**9. Mjetet e ndërlidhura me FMN**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Kuota me FMN	103,301,004.87	75,096,957.81
Depozitat në DST (SDR)	55,252,242.04	65,127,150.61
Kamata akruale	232,197.43	230,352.64
Përdorimi i fondeve të FMN-së (SBA)	123,978,401.84	127,747,244.04
Tarifa e zotimit të fondeve (Commitment Fee)	-	75,606.09
<b>Gjithsej</b>	<b>282,763,846.18</b>	<b>268,277,311.19</b>

Zërat më lartë rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Zëri i parë paraqet vlerën e kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga shkurt 2016; ndërsa ka qenë 59,000,000 SDR) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro. Ndërsa zëri i dytë paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të guvernatorëve të FMN-së me 28 Gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 Shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lartë.

Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 0.047% për periudhën raportuese.

Zëri *përdorim i fondeve të FMN-së* paraqet mjetet e marra nga FMN-ja sipas marrëveshjeve aktive për shfrytëzim të linjës kreditore (SBA) nga Qeveria e Kosovës. Ndryshimet kryesisht janë rrjedhe e disbursimeve dhe pagesave për të gjitha marrëveshjet aktive dhe pjesërisht nga ndryshimit në kursin e këmbimit EUR/SDR (vlerësimi i SDR-ve kundrejt EURO-s). Ndërsa tarifa e zotimit ndërlidhet me fondet e zotuara që akoma nuk janë shfrytëzuar.

**10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme**

Kategoria e Mjeteve Themelore	Kosto Historike	Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar i vitit deri me 30 Shtator 2016	Total Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar 30 Shtator 2016	Vlera Neto me 30 Shtator 2016
<b>Prona, Ndërtesat dhe Pajisjet</b>	<b>6,982,678.51</b>	<b>332,576.98</b>	<b>3,702,037.31</b>	<b>3,280,641.20</b>
Pajisje, zyre dhe tjera	1,847,850.23	81,273.75	1,548,373.07	299,477.16
Automjetet	320,149.16	21,719.79	225,434.13	94,715.03
Ndërtesa	2,341,408.02	83,193.83	760,391.71	1,581,016.31
Pajisjet kompjuterike	1,482,431.74	146,389.61	1,167,838.40	314,593.34
Pajisje në proces	990,839.36			990,839.36
<b>Mjetet e Paprekshme</b>	<b>3,435,448.05</b>	<b>155,769.53</b>	<b>1,377,855.15</b>	<b>2,057,592.90</b>
Aplikacionet kompjuterike	2,296,517.14	155,769.53	1,377,855.15	918,661.99
Aplikacione në proces	1,138,930.91	-	-	1,138,930.91
<b>Gjithsej</b>	<b>10,418,126.56</b>	<b>488,345.44</b>	<b>5,079,892.46</b>	<b>5,338,234.10</b>

**12. Mjetet tjera**

Mjetet tjera përbehen si më poshtë:

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Te hyra akruale	945,036.60	807,667.97
Parapagime	214,388.98	89,078.09
<b>Gjithsej</b>	<b>1,159,425.58</b>	<b>896,746.06</b>

**13. Detyrimet ndaj bankave në vend**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
ProCredit Bank - Kosovë	40,690,631.98	77,224,643.60
Raiffeisen Bank - Kosovë	68,881,931.98	51,931,582.28
NLB Prishtina	45,614,033.37	39,208,782.60
Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë	5,224,327.01	4,935,843.91
Banka Ekonomike e Prishtinës	28,996,472.28	17,572,209.96
Banka për Biznes	16,139,578.12	22,576,060.01
Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë	18,584,387.52	39,733,174.37
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A	43,250,710.96	51,008,722.51
Turkiye Is Bankasi A.S.	10,015,346.68	6,305,204.13
T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosove	924,699.45	5,850,515.15
Banka Kreditore e Prishtinës	129,680.43	59,130.21
<b>Gjithsej</b>	<b>278,451,799.78</b>	<b>316,405,868.73</b>

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave komerciale që operojnë në vend. Bankat komerciale që veprojnë në Kosovë në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit. Në total shuma e shpalosur më lartë për periudhën raportuese 30 Shtator 2016 është rreth 2.22 herë më e lartë se sa shuma e rezervës së obliguar për të mbajtur në BQK.

**14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Llogaria rrjedhëse FMN Nr. 1	258,252.51	187,742.39 €
Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2	6,253.09	6,364.15
Llogaria e FMN-së, në përkujdesje	201,927,514.21	184,626,825.40
Pjesa e paguar e Kuotës te FMN-ja	18,054,229.28	18,367,989.10
Alokime nga FMN-ja në formë të DST	69,244,705.82	70,474,565.68
Kamata akruale	233,362.83	230,797.81
<b>Gjithsej</b>	<b>289,724,317.74</b>	<b>273,894,284.53</b>

Zërat më lartë paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-ne që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN.

Të tre zërat e parë paraqesin llogari të hapura sipas rregullativës së FMN-së, dy janë llogari operative dhe një është llogari në përkujdesje për letrat me vlerë që Qeveria e Kosovës ka lëshuar si nota të pagueshme ndaj FMN-së.

Pjesa e paguar e kuotës është e mbajtur në SDR (14,160,000 SDR), e cila në tabelë më lartë është e shprehur në euro.

Te Drejtat Speciale të Tërheqjes (DST) në FMN janë alokimet e përmendura në *shënimi 9* sipas alokimeve me 28 Gusht dhe 09 Shtator 2009 (te dy alokimet se bashku janë në vlerë prej 55,368,413 SDR).

**15. Detyrimet ndaj Institucioneve qeveritare**

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

<b>Llogarit rrjedhëse</b>	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Thesari – Ministria e Financave	423,586,556.50	248,780,264.54
Agjencia Kosovare për Privatizim	462,465,175.30	486,819,224.92
Institucionet e përkohshme administrative	73,428.61	144,369.17
<b>Gjithsej (llogari rrjedhëse)</b>	<b>886,125,160.41</b>	<b>735,743,858.63</b>

Depozitat në llogari rrjedhëse përfitojnë kamatë prej 0.00% (si për periudhën raportuese, ashtu edhe periudhën krahasuese). Afatizime aktive në periudhën raportuese nuk ka, po ashtu edhe për vitin 2015 përkatësisht me 31 Dhjetor 2015 nuk ka pasur afatizime.

**16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale**

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura ne vijim të gjitha janë mjete në llogari rrjedhëse:

	30 Shtator 2016	31 Dhjetor 2015
Kompanitë e sigurimeve	4,497,183.01	4,528,394.93
Institucione dhe kompani publike	86,461,856.86	78,118,756.94
Fondet e pensioneve dhe tjera	1,803.83	1,821.83
<b>Gjithsej</b>	<b>90,960,843.70</b>	<b>82,648,973.70</b>

Kryesisht rritja krahasuar me 2015, i atribuohet llogarisë së Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) që si llogari ju ka bashkangjitur grupit ne 2016 si dhe llogarisë operative të Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK) e cila ka akumulon mjete konformë rregullativës se fondi.

**17. Detyrimet nga Huamarrja/et**

	30 Shtator 2016	31 Dhjetor 2015
Huamarrja nga Banka Botërore	1,310,961.46	680,116.58
<b>Gjithsej</b>	<b>1,310,961.46</b>	<b>680,116.58</b>

Në vitin 2016, dy projekte janë në proces dhe financohen nga Banka Botërore: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale* (RTGS). Projekti për *Sistemin e pagesave ne kohe reale* është ne funksion nga muaji korrik 2016.

**18. Detyrime tjera**

	30 Shtator 2016	31 Dhjetor 2015
Llogari në përkujdesje	756,036.51	756,036.51
Të hyrat e shtyra	657,652.42	631,532.05
Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale	250,346.77	411,546.75
<b>Gjithsej</b>	<b>1,664,035.70</b>	<b>1,799,115.31</b>

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim i lehtë në gjithsej saldon e grupit krahasuar me 31 Dhjetor 2015. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldosh së *llogarive të pagueshme* me 30 Shtator 2016, krahas asaj me 31 Dhjetor 2015.

**19, 20 Kapitali autorizuar dhe Rezervat**

Kapitali dhe rezervat e përgjithshme

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Kapitali i autorizuar	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondi i Rezervave	21,022,583.81	20,334,791.90
Rezultati neto i periudhës	1,573,437.13	687,791.91
<b>Gjithsej</b>	<b>52,596,020.94</b>	<b>51,022,583.81</b>

Rezultati financiar është pozitiv i ndikuar nga tre faktor dominant:

- i) të hyra më të larta të interesit,
- ii) të hyra më të larta nga tarifat në shërbime dhe nga aktiviteti rregullator, dhe
- iii) të hyrat nga rivlerësim valutë në periudhën raportuese (me ndikim të vogël).

Dy elementet e para janë faktor që duhet marrë për bazë pasi ata njëherit përbejnë bazën faktike të pozicioneve financiare në datën e raportimit. Elementi i tretë është gjendje e përkohshme dhe paraqitet si e hyrë e përealizuar (vetëm si rivlerësim) në datën e raportimit dhe si e tillë mund të ndryshojë varësisht nga ndryshimi në kursin e këmbimit EUR/SDR.

**21. Neto të hyrat nga kamatat**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
<b>Te hyrat nga kamata</b>		
Prej plasmanëve	604,443.43	305,205.79
Prej letrave me vlerë	700,877.32	23,900.03
Prej depozitave në llogari rrjedhëse	67,693.40	24,842.27
	<b>1,373,014.15</b>	<b>353,948.09</b>
<b>Shpenzimet e kamatave</b>		
Ndaj llogarive rrjedhëse	28,725.51	27,576.33
Ndaj bankave korrespondente	17,433.87	-
Në depozitat e afatizuar	-	8,001.38
Nga huazimi/et	6,043.70	2,509.71
	<b>52,203.08</b>	<b>38,087.42</b>
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	<b>1,320,811.07</b>	<b>315,860.67</b>

Siç mund të vërehet nga tabela nën shënim 21, të hyrat nga kamatat janë rreth 4.2 herë më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo ka qenë një prej faktorëve kryesor që të kemi rezultat pozitiv për përdhën e raportimit (edhe pa rivlerësim valutë). Normat mesatare të kamatës për neto të hyrat nga kamatat (duke marrë në konsideratë vetëm portfolion e angazhuar) sillen në rreth 0.193% (në periudhën e njëjte të vitit 2015 0.043%). Nëse e marrin në konsideratë gjithsej portfolion kemi normën mesatare prej 0.156% të neto kamatës së realizuar.

**22. Neto te hyrat nga tarifat dhe ndalesat ne shërbime**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
<b>Te hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>		
Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme	337,131.72	317,070.94
Nga transferet hyrëse	53,316.53	38,010.75
Nga transferet dalëse	237,327.27	192,872.90
Nga transferet vendore ( <i>Sistemi i pagesave vendore</i> )	658,544.37	361,194.92
Nga sistemi i regjistrimit të kreditove	95,451.80	87,288.90
Nga menaxhimi i mjeteve Thesarit	-	25,000.00
Të hyra nga tarifa tjera	25,425.40	20,442.00
	<b>1,407,197.09</b>	<b>1,041,880.41</b>
<b>Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat</b>		
Prej transportit të parasë së gatshme	190,613.26	287,335.70
Nga transaksionet me banka korrespondente	8,463.91	3,028.33
Prej shërbimeve te pagesave përmes SNP	-	-
	<b>199,077.17</b>	<b>290,364.03</b>
<b>Neto pozicioni nga tarifat dhe ndalesat</b>	<b>1,208,119.92</b>	<b>751,516.38</b>

Kemi rritje krahasuar me 30 Shtator 2015, kjo e rrjedhe nga rritja e tarifave në shërbime nga 01 Janar 2016. Rritja e tarifave është e mbështetur në ligjin për BQK-në dhe në analizën e kostos për shërbimet përkatëse. Po ashtu edhe në vlerësimet se rritja nuk ndikon në tregun e shërbimeve financiare (p.sh. nëse shikojmë tarifën bazë për transaksione normale dhe masive normale përmes sistemit ndërbankar të pagesave ajo është mesatarisht 12 cent ndërsa mesatare e bankave komerciale është 1.36 euro).

**23. Te hyrat nga aktiviteti rregullator**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
Nga mirëmbajtja e licencave të bankave	1,803,363.58	1,480,691.64
Nga licencat prej institucioneve bankare	15,200.00	13,600.00
Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive te sigurimeve	816,954.34	757,567.43
Nga licencat prej kompanive te sigurimeve	178,950.00	127,450.00
Te hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale	16,759.12	9,024.03
Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jo bankare)	117,367.66	105,513.03
<b>Gjithsej</b>	<b>2,948,594.70</b>	<b>2,493,846.13</b>

Këtu kemi një rritje prej rreth 18% në gjithsej grupin. Kjo rritje kryesisht është e mbështetur në ndryshimet në tarifat të hyra në fuqi nga 01 Janar 2016. Dhe kryesisht është e rrjedhe nga zëri i parë i këtij grupi.

**24. Të hyrat nga grantet**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
Të hyrat nga grantet	<b>49,964.52</b>	<b>49,964.52</b>

Dy janë grantet që aktualisht efektojnë zërin në shënim 24. Ato janë granti për sistemin e menaxhimit të tërë procesit të *emetimeve të letrave me vlerë të qeverisë* (faktikisht i tërë sistemi është dhënë si grant, pastaj financimi pjesërisht në formë të grantit për sistemin e *regjistrimit të kreditëve*. Efekti në të hyra nga këto dy grante është i shpalosur në kuadër të këtij shënimi.

**25. Të hyrat tjera operative**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
<b>Të hyra tjera</b>	<b>4,127.99</b>	<b>1,176.17</b>

Të hyra nga aktivitete jo të zakonshme të BQK-se dhe te cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifik te të hyrave.

**26. Shpenzimet e personelit**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve	2,059,029.23	1,830,939.08
Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor	467,635.13	447,432.25
Shpenzimet e trajnimeve	51,905.91	34,171.56
Shpenzimet për Bordin e BQK-së	71,492.94	73,834.02
Shujta ditore	95,962.50	92,500.50
Shpenzime tjera	22,711.50	22,369.55
<b>Gjithsej</b>	<b>2,768,737.21</b>	<b>2,501,246.96</b>

Gjithsej numri i punëtorëve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar-shtator 2016 është: 218 (ne janar - shtator 2015: 204).

Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtor kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimit ndaj tyre te fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.



**27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
Shpenzimet e sigurimit	147,661.04	133,500.01
Riparime dhe mirëmbajtje	27,948.72	21,345.15
Mirëmbajtje të aplikacioneve	199,294.96	206,909.65
Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti)	10,712.96	21,005.23
Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale	52,668.05	58,838.25
Shpenzimet e konsultimeve dhe të auditimit	-	26,023.75
Shpenzime të sigurimit fizik (të objektit dhe të transportit)	38,320.00	34,600.00
Udhëtimet dhe transporti	97,904.36	89,140.47
Shpenzimet operative të automjeteve	18,116.10	17,195.67
Material shpenzues administrativ	12,433.48	25,100.46
Shpenzimet e bufësë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme)	22,791.59	15,934.41
Shpenzime për furnizime (për pajisje të TI dhe jo TI)	16,068.91	15,348.64
Publikimet dhe literatura	10,588.63	8,934.01
Shpenzime të përfaqësimit	110,584.52	31,547.79
Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale	20,394.59	22,276.92
Tjera*	18,645.89	7,615.79
<b>Gjithsej</b>	<b>804,133.80</b>	<b>735,316.20</b>

Shpenzimet e larta të përfaqësimit janë kryesisht rrjedhojë e organizimit si nikoqir për garat sportive rajonale të bankave qendrore që tashme janë kthyer si organizim tradicional dhe se BQK merr pjese prej vitit 2008.

**28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit**

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>30 Shtator 2015</b>
Neto fitimi/humbja e përealizuar nga kursi i këmbimit	<b>103,036.45</b>	<b>(122,917.09)</b>

Rezultati i paraqitur më lartë është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR.

**29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj**

<b>Shënim</b>		<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
Paraja e gatshme	5	183,524,699.56	15,281,539.78
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente	6	214,238,196.88	241,187,046.29
Letra më vlerë me maturitet deri në tre muaj		4,999,906.65	2,864,220.69
Llogaritë depozituese me bankat jo rezidente dhe me maturitet deri në tre muaj		20,051,207.74	0.00
<b>Gjithsej</b>		<b>422,814,010.84</b>	<b>259,332,806.76</b>

**30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente****Anëtarësimi ne Bankën Botërore**

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguaj sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre me 30 Shtator 2016 është rreth 645,152 euro (me 31 dhjetor 2015 ky detyrim i pritshëm ka qenë 645,152 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën-përkujdesje (garantuese).